Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 22 gusht 2012

Lënda nr. 15/08

Mirosllav MIHAJLOVIQ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 22 gusht 2012,
me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Z. Paul LEMMENS, kryesues
Znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pasi vuri në dukje tërheqjen e z. Marek Nowicki nga seanca për rastin në pajtim me rregullën 12 të Rregullores së punës,

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, eparashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, paraqet gjetjet si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa i është paraqitur Panelit më 12 qershor 2008 dhe është regjistruar po të njëjtën datë.

2. Më 21 korrik 2008, Paneli kërkoi nga ankuesi që të paraqesë informata dhe dokumente shtesë lidhur me ankesën. Një përgjigje është pranuar më 10 shtator 2008.

3. Më 29 tetor 2008, Paneli kërkoi informata dhe dokumente relevante lidhur me ankesën nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP). Një përgjigje është pranuar më 19 nëntor 2008. Përgjigja e AKP-së iu dërgua ankuesit për dhënien e komenteve më 2 dhjetor 2008, dhe përsëri më 2 shkurt 2009. Një përgjigje prej ankuesit është pranuar më 8 qershor 2009 nga Paneli.

4. Më 24 shtator 2009, Paneli e njoftoi për rastin Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesës. PSSP-ja u përgjigj përmes letrës të datës 14 tetor 2009. Më 24 nëntor 2009, përgjigjja e PSSP-së iu dërgua ankuesit për dhënien e komenteve.

5. Një letër e datës 15 qershor 2010 iu dërgua ankuesit, duke e ftuar atë edhe njëherë për të paraqitur informata dhe komente shtesë për rastin. Një përgjigje prej ankuesit është pranuar nga Paneli më 13 shtator 2010.

6. Më 16 dhjetor 2010, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme.

7. Më 20 dhjetor 2010, Paneli e informoi PSSP-në për vendimin dhe kërkoi komentet e UNMIK-ut mbi bazueshmërinë e ankesës. Më 20 janar 2011, PSSP-ja e dha përgjigjen e UNMIK-ut.

8. Më 16 mars 2011, Paneli ia dërgoi komentet e PSSP-së ankuesit dhe e ftoi atë që të paraqesë komente shtesë, nëse dëshironte. Më 19 tetor 2011, Paneli përsëri ia dërgoi komentet e PSSP-së ankuesit, duke e ftuar atë për dhënien e komenteve shtesë të tij. Megjithatë, nuk është pranuar asnjë përgjigje.

II. FAKTET

9. Ankuesi është ish-banor i Kosovës, i cili aktualisht jeton në Serbi. Ai është pronar i një shtëpie në Prizren. Ankuesi deklaron se, qysh prej se është larguar nga Kosova për shkaqe sigurie, shtëpia e tij ka qenë e uzurpuar në mënyrë të paligjshme nga një person i tretë.

10. Më 1 korrik 2002, ankuesi paraqiti ankesë pranë Komisionit për Kërkesa Pronësoredhe Banesore (KKPB) të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB) për ta rimarrë në posedim shtëpinë e tij. Më 18 qershor 2004, KKPB lëshoi një vendim në favor të tij, duke e konfirmuar të drejtën e tij në pronë.

11. Diku mes vitit 2004 dhe 2005, ankuesi kërkoi nga DÇPB që ta marrë nën administrim pronën e tij. Kërkesa e tij u plotësua. Ankuesi deklaron që prona e tij më vonë u përfshi në skemën e qirasë, e cila u krijua në tetor të vitit 2006 nën administrimin e AKP-së, pasardhëse në interes e DÇPB-së.

12. Ankuesi deklaron se, për shkak që nuk mori asnjë pagesë të qirasë, më 18 shtator 2007 ai kërkoi ndërprerjen e administrimit të DÇPB/AKP. Ai nënshkroi një formular të kërkesës, në të cilin në pjesët relevante shkruan si një vijim:

> "Unë e kuptoj që DÇPB-ja do të më kontaktoj dhe do të ma ofroj rimarrjen në posedim në një datë dhe kohë të caktuar. Unë do të konsiderohem se e kam rimarrë pronën në atë kohë, pavarësisht nëse i kam marrë çelësat e pronës apo jo. Unë gjithashtu e kuptoj se DÇPB lirohet nga çdo obligim lidhur me pronën pas kohës së rimarrjes në posedim. DÇPB nuk do të ekzekutojë një dëbim tjetër nga prona pas kohës së rimarrjes në posedim ose ta marrë pronën nën administrim."

13. Më 1 tetor 2007, kërkesa e ankuesit për rimarrjen në posedim u plotësua dhe një urdhër për dëbimin nga prona ,AKP-ja ia dërgoi uzurpuesit për ta liruar pronën brenda 90 ditëve, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/60, datë 31 tetor 2000, mbi Kërkesat Pronësore dhe Banesore dhe Rregulloren e punës dhe të dhënat e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.

14. Pasi që uzurpuesi nuk e ka liruar pronën vullnetarisht, AKP-ja e zbatoi një dëbim më 23 maj 2008. Sipas AKP-së, në këtë datë gjësendet e uzurpuesit u larguan nga shtëpia e ankuesit, bravat u ndërruan, prona u sigurua nga vërshimet dhe nga zjarri dhe i është vënë dryni.

15. Çelësat e pronës i mori përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit më 4 qershor 2008, nga Zyra e AKP-së në Prizren. Lidhur me këtë, ankuesi deklaron që përfaqësuesi i tij ishte në dispozicion për marrjen e çelësave nga dita e deklaruar si datë për dëbim. Megjithatë, çelësat atij iu dhanë vetëm 14 ditë pas zbatimit të dëbimit.

16. Ankuesi deklaron që kur përfaqësuesi i tij shkoi te prona më 4 qershor 2008, ai zbuloi se prona ishte ri-uzurpuar nga uzurpuesi i mëparshëm. Sipas ankuesit, AKP-ja ia kishte vënë drynin vetëm njërës nga dy hyrjet e shtëpisë dhe uzurpuesit e mëparshëm kishin arritur ta ri-uzurponin shtëpinë përmes hyrjes, së cilës nuk i është vënë dryni.

17. Deri më tani, ankuesi nuk ka mundur ta rimarrë pronën e tij. Përveç kësaj, ankuesi deklaron që ai nuk ka marrë asnjë pagesë të qirasë për tërë kohën gjatë së cilës shtëpia ka qenë e uzurpuar.

III. ANKESA

18. Ankuesi ankohet që autoritetet përkatëse kanë dështuar në ekzekutimin e vendimit të KKPB-së, të datës 1 tetor 2007, që përbën shkelje të së drejtës së tij për një gjykim të drejtë sipas nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

19. Ankuesi gjithashtu ankohet që dështimi për zbatimin e vendimit të KKPB-së ia ka pamundësuar atij që ta rimarrë shtëpinë e tij, dhe kështu përbën një shkelje të së drejtës së tij për zotërimin e lirë të pronës së tij sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

20. Përveç kësaj, ankuesi ankohet që ai nuk ka marrë asnjë qira për kohën gjatë së cilës prona e tij ka qenë e uzurpuar, e cila përfshin periudhën kur prona e tij ka qenë nën

administrimin e DÇPB/AKP-së. Prandaj, e drejta e tij pronësore (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së) përsëri është shkelur.

IV. LIGJI

A. Shkelja e pretenduar e nenit 6 § 1 të KEDNJ-së lidhur me zbatimin e vendimit të KKPB-së

a. Argumentet e palëve

21. Ankuesi deklaron që autoritetet kompetente, në veçanti DÇPB/AKP, kanë dështuar në zbatimin e vendimit të KKPB-së, duke ia pamundësuar që ta rimarrë pronën e tij. Ai i referohet shkeljes të së drejtës së tij për zbatimin e vendimit, e garantuar sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së.

22. Ankuesi deklaron që përfaqësuesi i tij ka kërkuar nga AKP-ja që të jetë i pranishëm gjatë dëbimit, në mënyrë që të vërtetojë se çdo gjë është duke u zbatuar në mënyrën e duhur dhe t'i kontrollojë kushtet në të cilët gjendet shtëpia. Megjithatë, kjo kërkesë u refuzua. Përveç kësaj, edhe pse dëbimi u realizua më 23 maj 2008, çelësat e banesës iu dhanë përfaqësuesit të tij vetëm më 4 qershor 2008. Në atë kohë, përfaqësuesi i autorizuar kërkoi nga zyrtarët e AKP-së që ta shoqëronin atë deri te shtëpia e ankuesit, për të vërtetuar se shtëpia ishte liruar. Megjithatë, AKP-ja edhe këtë kërkesë e refuzoi. Te shtëpia, përfaqësuesi i ankuesit zbuloi se ajo ishte ri-uzurpuar nga uzurpuesi i mëparshëm, i cili e kërcënoi atë dhe i kërkoi që të largohej menjëherë. Sipas ankuesit, shtëpia e tij i ka dy hyrje të ndryshme, por vetëm njërës prej tyre i ishte vënë dryni nga AKP-ja, kurse tjetra ishte përdorur nga uzurpuesi i mëparshëm për të hyrë sërish në shtëpi. Ankuesi konkludon se ri-uzurpimi ndodhi me pranim të heshtur nga ana e autoriteteve.

23. Ankuesi argumenton që ekzekutimi i vendimit të formës së prerë dhe detyrues është pjesë integrale e garantimit për gjykim të drejtë, pasi që vetëm me ekzekutimin e një vendimi të tillë të drejtat bëhen efektive. Prandaj, ai argumenton që dështimi i zbatimit të vendimit, të datës 1 tetor 2007 të KKPB-së, përbën një shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së.

24. Në komentet e tij, PSSP-ja argumenton që nuk është bërë shkelja e nenit 6 § 1 të KEDNJ-së që mund t'i atribuohet DÇPB/AKP ose UNMIK-ut dhe se vendimi i lartpërmendur i KKPB-së ishte zbatuar sipas procedurave të parapara me ligj. PSSP-ja deklaron qëështë e vendosur në mënyrë të qartë në ligjin e zbatueshëm, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/60 dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/50, të datës 16 tetor 2006, mbi Zgjidhjen e Kërkesave Lidhur me Pronat Private të Paluajtshme, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, se DÇPB/AKP e ka për detyrë të kryejë vetëm një dëbimsipas kërkesës së mbajtësit të së drejtës në pronë. Pas kryerjes së dëbimit të tillë, rasti konsiderohet i mbyllur nga perspektiva e DÇPB/AKP.

25. PSSP-ja mbron atë se procedura e dëbimit në përgjithësi do të obligonte lirimin e pronës, sigurimin e saj nga zjarri dhe vërshimet, ndërrimin e bravave dhe vënien e drynit. Në lëndën aktuale, prona e ankuesit ishte liruar dhe i ishte vënë dryni më 23 maj 2008 në pajtim me nenin 16.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, në të cilin

thuhet se "... pas zbatimit të urdhrit për dëbim, nëse ankuesi nuk është i pranishëm për ta marrë menjëherë pronën nën zotërimin e tij, zyrtari përgjegjës do t'ivë drynin pronës dhe do ta lajmërojë ankuesin." Sa i përket kësaj, PSSP-ja thekson se "me nënshkrimin e kërkesës për rimarrjen në posedim nga data 18 shtator 2007, ankuesi në mënyrë të qartë e ka shprehur se, e ka kuptuar që ai do të konsiderohej se e ka rimarrë pronën, pavarësisht nëse ai ose përfaqësuesi i tij i autorizuar i merr çelësat e pronës në të njëjtën ditë të rimarrjes në posedim. Përveç kësaj, atij i është bërë me dije dhe ai është pajtuar që DÇPB/AKP lirohet nga çdo obligim tjetër lidhur me pronën, përfshirë ndonjë dëbimi tjetër me rastin e ri-uzurpimit".

26. Sa u përket pretendimeve të ankuesit që dëbimi nuk është kryer në mënyrën e duhur dhe nuk i është vënë dryni në mënyrë efektive të gjitha hyrjeve në pronë, PSSP-ja argumenton që ankuesi nuk ofron asnjë dëshmi për mbështetjen e këtyre pretendimeve. Për më tepër, PSSP argumenton se ajo çka është më e rëndësishmja është se prona është mbyllur me dry "sipas ligjit" gjatë dëbimit, kështu që ajo është bërë e pacenueshme pas kësaj kohe nga hyrja prej cilitdo person tjetër, përveç mbajtësit të së drejtës në pronë. PSSP-ja deklaron që sipas politikës së DÇPB/AKP, personat të cilët janë ankuar për pronat e tyre se janë ri-uzurpuar pas dëbimit, duhet të lajmërohen që t'ia paraqesinçështjen Policisë së Kosovës, pasi që DÇPB/AKP nuk e ka në mandatin e saj që të përfshihet më tej në nje rast të tillë.

27. PSSP-ja argumenton që pas dëbimit dhe mbylljes me dry të pronës sipas ligjit, çfarëdo uzurpimi i paligjshëm i shtëpisë do të përbënte vepër penale me të cilën duhet të merren autoritetet e zbatimit të ligjit. Megjithatë, në rastin në fjalë, ankuesi nuk ka siguruar dëshmi, përmes të cilave do të sugjeronte të ketë ndërmarrë hapa drejt paraqitjes së uzurpimit të paligjshëm të pretenduar të pronës së tij te Policia e Kosovës.

b. Vlerësimi i Panelit

28. Ankuesi ankohet që, për shkak se ai nuk ka mundur ta rimarrë në posedim shtëpinë e tij, nuk është ekzekutuar vendimi i detyrueshëm i KKPB-së. Ai deklaron që e drejta e tij për gjykim të drejtë siç parashihet me nenin 6 § 1 të KEDNJ-së, është shkelur me dështimin e këtij zbatimi.

29. Paneli rikujton që KKPB, edhe pse nuk është një gjykatë e formës klasike, ishte ligjor për nga funksioni, dhe se neni 6 zbatohet në procedurat para KKPB (shih, p.sh., Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ), *Vuçkoviq*, nr. 03/07, mendimi i 13 marsit 2010, § 34; PKDNJ, *Gjorgjeviq*, nr. 03/09, vendimi i 12 gushtit 2011, § 26).

30. Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për çështjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Gjykata vazhdimisht mbron atë se neni 6 § 1 i KEDNJ-së garanton për të gjithë të drejtën që të kenë vendim nga një gjykatë apo tribunal për çdo ankesë të tyre lidhur me të drejtat dhe obligimet civile. E drejta do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor i një shteti lejon një vendim gjyqësor të formës së prerë, detyrues të mbetet i paefektshëm në dëm të njërës palë. Sipas gjykatës, do të ishte e papërfytyrueshmeqë neni 6 § 1 të përshkruajë në detaje garancitë procedurale që u jepen palëve - proceduraveqë janë të paanshme, publike dhe ekspeditive – pa mbrojtur gjithashtu edhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Zbatimi i një vendimi të sjellë nga ndonjë gjykatë, pra shihet si pjesë integrale e "gjykimit" sipas qëllimeve të nenit 6 të KEDNJ-së dhe madje edhe një vonesë e gjatë e paarsyeshme në ekzekutimin e vendimit detyrues mund të përbëjë shkelje të nenit 6 (shih në mesin e vendimeve të tjera, GJEDNJ, *Hornsby kundër Greqisë*, vendimi i gjykatës, 19 mars 1997, *Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve*, 1997-II, p. 510, § 40; GJEDNJ, *Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3738/02, vendimi i gjykatës, 18 dhjetor 2007, § 126; GJEDNJ, *Burdov kundër Rusisë (nr. 2)*, nr. 33509/04, vendimi i gjykatës, 15 janar 2009, §§ 65-67; shih gjithashtu PKDNJ, *Vuliq*, nr. 05/07, mendimi i 15 marsit 2011, § 50).

31. Duke pasur parasysh praktikën gjyqësore të lartpërmendur të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Paneli do t'i konsiderojë pretendimet e ankuesit nga këndvështrimi për të drejtën për gjykatë, në veçanti të së drejtës për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe detyrues. Paneli konsideron se lidhur me këtë, shtrohet pyetja nëse vendimi i KKPB-së mund të konsiderohet i zbatuar në mënyrën e duhur me dëbimin e realizuar nga AKP-ja, më 23 maj 2008.

32. Paneli thekson se zbatimi i vendimeve të KKPB-së përmes të cilat urdhërohet rimarrja e pronës, rregullohet me Rregullorene UNMIK-ut nr. 2000/60 dhe Rregullorene UNMIK-ut nr. 2006/50. Në dispozitat përkatëse të ligjit përshkruhet si në vazhdim:

> "Pronari ... i pronës nën administrimin e (DÇPB) mund ta lajmërojë Drejtorinë për qëllimin e tij/saj që ta kthejë pronën në posedimin e tij/saj. Duke zbatuar kërkesën nga pronari ... Drejtoria do ta dërgojë një lajmërim për dëbim, përmes të cilit kërkon nga uzurpuesi aktual që ta lirojë pronën brenda 90 ditëve, dhe nëse uzurpuesi vullnetarisht nuk e liron pronën, atëherë Drejtoria lëshon urdhrin përmes të cilit autorizon zbatimin e dëbimit ..." (neni 12.7 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60).
>
> "(DÇPB) mund, me vetëiniciativë, ta vonojë zbatimin e një urdhri për dëbimderi në gjashtë muaj, në pritje të një zgjidhjeje për sigurimin e nevojave për banim të uzurpuesit aktual. (DÇBP) do ta informojë uzurpuesin në fjalë dhe ankuesin për arsyet e vonesës" (neni 13.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60).
>
> "(DÇPB/AKP) do ta njoftojnë ankuesin dhe cilindo person që e ka zënë pronën për ditën e caktuar për dëbim. Pas zbatimit të urdhrit për dëbim, nëse ankuesi nuk është i pranishëm që ta marrë menjëherë në posedim pronën, zyrtari përgjegjës do t'ia vë drynin pronës dhe do ta njoftojë ankuesin. Secili person i cili, pa justifikim ligjor, hyn në pronë duke e thyer drynin, do t'i nënshtrohet dëbimit nga prona nga ana e autoriteteve për zbatim të ligjit" (Neni 13.6 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60 dhe neni 16.5 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/60).

33. Paneli thekson se ligji i zbatueshëm nuk kërkon që pronari apo përfaqësuesi i tij autorizuar të jenë të pranishëm gjatë dëbimit, ose që çelësat e pronës t'i dorëzohen pronarit në kohën e dëbimit, në mënyrë që zbatimi i një urdhri për dëbim të kryhet në mënyrën e duhur. Sa i përket kësaj, Paneli gjithashtu thekson se ankuesit, gjatë nënshkrimit të formularit për rimarrje në posedim, iu bë me dije për këto aspekte të procedurës dhe se ai do të konsiderohej ta ketë rimarrë shtëpinë me njoftimin se

shtëpisë së tij i është vënë dryni. Paneli gjithashtu thekson që ankuesi nuk ka kontestuar pranimin e këtij njoftimi.

34. Sa u përket pretendimeve të ankuesit që nuk ishin ndërruar të gjitha bravat e jashtme të pronës dhe se nuk u ishte vënë dryni të gjitha hyrjeve, Paneli thekson që ankuesi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi për t'i mbështetur këto pretendime. Përveç kësaj, Paneli ndan të njëjtin këndvështrim me PSSP-në që vendosja e drynit pronës nga DÇPB/AKP, po që se është bërë me kujdesin e duhur, duhet të kuptohet sipas kuptimit ligjor dhe se çdo person, i cili hyn në pronën së cilës i është vënë dryni, i nënshtrohet dëbimit nga ana e autoriteteve për zbatim të ligjit. Lidhur me këtë, Paneli thekson se nuk ka të dhëna në ankesë ose në parashtresat pasuese te Paneli që ankuesi t'i ketë kontaktuar autoritetet për zbatim të ligjit që të raportojë se prona e tij ishte uzurpuar në mënyrë të paligjshme.

35. Në këto rrethana, Paneli konsideron që vendimi i KKPB-së i 1 tetorit 2007, që i garanton ankuesit rimarrjen në posedim të pronës së tij, ishte zbatuar në mënyrën e duhur nga AKP-ja me dëbimin e realizuar më 23 maj 2008. Duke shprehur keqardhje që ankuesi nuk ka mundur ta rimarrë pronën e tij deri më tani, Paneli konsideron se, pas dëbimit të parë, AKP-ja nuk bart më përgjegjësi.

36. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së.

37. Megjithatë, Paneli thekson se kjo situatë faktike nuk është epazakonshmedhe se sistemi i krijuar për të marrë në ri-posedim pronën për personat e zhvendosur nga Kosova, ka qenë i vështirë dhe përplot me pasiguri.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së sa i përket zbatimit të vendimit të KKPB-së.

38. Ankuesi thekson se për shkak që nuk iu mundësua ta rimarrë në posedim shtëpinë e tij, është shkelur neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, i cili garanton të drejtën e tij për ta gëzuar pronën e tij.

39. Paneli gjithashtu thekson se shkelja e pretenduar e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së qëndron në argumentet e ankuesit në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së. Pasi që nuk ka konstatuar asnjë shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, Paneli në të njëjtën mënyrë konstaton se nuk ka pasur as shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, për arsyet e cekura më lart (shih PKDNJ, *Vuçkoviq*, përmendur në § 29 më lart, në § 60; PKDNJ, *Angjelkoviq*, nr. 11/07, mendimi i 17 dhjetorit 2010, § 108; PKDNJ, *Vuliq*, përmendur në § 30 më lart, në § 65).

C. Shkelja e pretenduar e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së sa i përket mospagesës së qirasë

40. Ankuesi ankohet që e drejta e tij në pronë është shkelur për shkak të mospagesës së qirasë për pronën e tij, përfshirë kohën kur prona e tij ka qenë nën administrim të DÇPB/AKP-së.

41. Në komentet e tij, PSSP-ja deklaron që prona e ankuesit do të mund të përfshihej në skemën e qirasë së DÇPB/AKP-së vetëmnga tetori 2006, kur skema e qiradhënies hyri në funksion. Për më tepër, as DÇPB-ja e as AKP-ja nuk kanë garantuar asnjë të ardhur nga pronat që ishin përfshirë në skemën e qirasë, duke përfshirë rastet kur një qiramarrës mund të jetë pajtuar për të paguar, por nuk ka paguar.

42. Sa i përket këtij aspekti të ankuesit, Paneli tashmë ka theksuar se AKP-ja nuk garanton se do të realizohet ndonjë e ardhur nga prona, e as nuk garanton që do të gjendet një qiramarrës që paguan qiranë për të banuar në pronë. Pagesa mund t'i jepet pronarit vetëm nëse qiramarrësi ia paguan qiranë AKP-së (shih PKDNJ, *Trajkoviq*, nr. 35/08, vendimi i 17 prillit 2009, § 20; PKDNJ, *Sokoli*, nr. 14/08, vendimi i 17 marsit 2011, § 26).

43. Ankesa dhe informatat pasuese të marra nuk përmbajnë asnjë dëshmi për të mbështetur konkluzionin që e drejta e ankuesit për ta mbrojtur pronën ishte shkelur, për shkak të dështimit të AKP-së për të paguar ndonjë shumë të qirasë që ishin borxh ndaj ankuesit (shih, PKDNJ, *Sokoli*, përmendur në § 42 më lart, në § 27).

44. Prandaj, Paneli është i mendimit që nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së sa i përket kësaj pjese të ankesës.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht.

1. **KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;**

2. **KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT LIDHUR ME ZBATIMIN E VENDIMIT TË KOMISIONIT PËR KËRKESA PRONËSORE DHE BANESORE;**

3. **KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT LIDHUR ME MOSPAGESËN E QIRASË.**

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Paul LEMMENS
Kryesues